



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **VII-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2026.**

Seanca mbahet **më 31.07.2026 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsytimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.06.2026;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) nga mbledhja e mbajtur më 09.07.2026;
4. Shqyrtimi i Raportit të Menaxhimit Financiar për periudhën janar–qershor 2026 (ref. Drejtoria e Financave);
5. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2025 (ref. EKZ);
6. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) (ref. EKZ);
7. Rishqyrtimi i Vendimit nr. 01Nr.06-15184/2026 për hartimin e Hartës Zonale (ref. Drejtoria për Urbanizëm);
8. Shqyrtimi i petitionit me nr. 06-351-19272/26, i parashtruar nga Lagjja „Dukagjini“, Klinë (ref. EKZ);
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarëve të KKSBB-së(ref.EKZ)
10. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi me qytetarë, i mbajtur nga Kryetari i Komunës më 23.06.2026;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave (ref. DKA);
12. Informatë nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 (ref. DKA);
13. Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me funksionimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) (ref. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale);

14. Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave publike në Komunën e Klinës (ref. DSHPE);
15. Informatë mbi realizimin e planit të punës së Zyrës së Prokurimit për periudhën janar-qershor 2026 (ref. Zyra e Prokurimit);
16. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 (ref. EKZ);
17. Pyetje dhe përgjigje.

01Nr. 06-21789 /2026
Klinë, me 20.07 /2026



Kryesuesi i Kuvendit,
Enver Berisha